

*Zyra e Rregullatorit për Energji
Rr. Hamdi Mramori Nr. 1
Prishtinë 10000 – Kosovë
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext 103
Fax: +381 (0) 38 247 620
e-mail: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org*

Zyra e Rregullatorit për Energji

**Rregulla për vënien e çmimeve të Gjenerimit
(Rregulla e Çmimeve të Gjenerimit)**

D R A F T

2011

Përmbajtja

Kapitulli 1	Kushtet e Përgjithshme	3
Neni 1	Hyrje	3
Neni 2	Qëllimi dhe Fushëveprimi	3
Neni 3	Definicionet dhe përkufizimet	3
Kapitulli 2	Ngarkesat e Gjeneratorëve të Rregulluar	6
Neni 4	Parimet e Përgjithshme	6
Neni 5	Shqyrtimet Periodike dhe Periudhat Rregullative	7
Neni 6	Përshtatjet e Rregullta	7
Neni 7	Shqyrtimet e Jashtëzakonshme	7
Kapitulli 3	Të Hyrat Maksimale të Lejuara	8
Neni 8	Parimet e Përgjithshme	8
Neni 9	Kostot e Lejuara Fikse dhe Operative	9
Neni 10	Zhvlerësimi i Lejuar	9
Neni 11	Kthimi i Lejuar në Kapital	9
Neni 12	Komponenta Fikse e Kostove të Furnizimit me Thëngjill	9
Kapitulli 4	Kostot për Energji	9
Neni 13	Parimet e Përgjithshme	9
Neni 14	Kostot e Lejuara Operative Varibile	10
Neni 15	Komponenta Variabile e Kostos së Furnizimit me Thëngjill	10
Neni 16	Kostot e tjera të furnizimit me lëndë djegëse	10
Neni 17	Pass-Through of Licence Fee	11
Kapitulli 5	Kostot e Furnizimit me Thëngjill	11
Neni 18	Parimet e Përgjithshme	11
Kapitulli 6	Ngarkesat për Kapacitet	11
Neni 19	Parimet Themelore	11
Neni 20	Procedura e Aprovimit të Ngarkesëve për Kapacitet	12
Kapitulli 7	Ngarkesat për Energji	12
Neni 21	Parimet Themelore	12
Neni 22	Procesi i Aprovimit të Ngarkesave për Energji	12
Shtojca 1	Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Llogaritja e Kostos së Energjisë	13
Shtojca 2	Baza e Aseteve të Rregulluara	17
Shtojca 3	Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit	19
Shtojca 4	Procesi i Shqyrtimit Periodik	21
Shtojca 5	Procesi i Përshtatjeve të Rregullta	23
Shtojca 6	Procesi i Shqyrtimeve të Jashtëzakonshme	24
Shtojca 7	Ngjarja e Jashtëzakonshme	26
Shtojca 8	Ngjarja e Forcës Madhore	27
Shtojca 9	Provizionet Tranzitore	28

KAPITULLI 1 KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Hyrje

- 1 Kjo Rregull është miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (“Rregullatorit”) në seancën publike të mbajtur më [data], në bazë të autoritetit të dhënë në Nenin 8 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 2 Qëllimi dhe Fushëveprimi

- 1 Kjo Rregull cakton:
 - 1.1 Bazën për përcaktimin e Të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe të Kostove të Energjisë që mund të mbliidhen nga Gjeneratorët e Rregulluar Brenda një Viti Relevant në mënyrë që këta Gjeneratorë t’i mbulojnë kostot e arsyeshme të operimit, mirëmbajtjes dhe të investimeve në stabilimentet Gjeneruese për qëllim të furnizimit ndaj Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (“FPEE”) në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë; dhe
 - 1.2 Procedurën sipas së cilës do të Shqyrtohen dhe ri-caktohen këto Të Hyra Maksimale të Lejuara dhe Kosto të Energjisë.

Neni 3 Definicionet dhe përkufizimet

- 1 Shprehjet e përdorura në këtë Rregull kanë këtë kuptim:
 - 1.1 “Të Hyra të Rregulluara Aktuale” nënkupton të Hyrat e mbuluara nga Gjeneratori i Rregulluar nga Furnizuesi Publik, përmes ngarkesave dhe provizioneve për energji dhe kapacitet si dhe çdo e hyrë tjetër e përcaktuar nga Rregullatori, matur në baza aktuale;
 - 1.2 “Plan i Aprovuar Investiv” e ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 2;
 - 1.3 “Caku i Disponueshmërisë” nënkupton nivelin e caktuar të Kapacitetit në Dispozicion brenda vitit, i cili përshtatet për mirëmbajtje të rregullta, dalje jashtë sistemit dhe shkaqe tjera të padisponueshmërisë;
 - 1.4 “Kapaciteti në Dispozicion” nënkupton kapacitetin e Gjeneratorëve të Rregulluar që është në dispozicion për furnizim;
 - 1.5 “Ditë Pune” quhen të gjitha ditët e punës brenda një jave, të përcaktuara sipas Ligjeve në Kosovë;
 - 1.6 “Ngarkesa për Kapacitet” nënkupton ngarkesën për njësi të kapacitetit në dispozicion, të vlerësuar në përputhje me Kapitullin 6;
 - 1.7 “Jetëgjatësia Ekonomike” nënkupton jetëgjatësinë e përdorur për llogaritjen e zhvlerësimit të lejuar nga Baza e Aseteve të Rregulluara;
 - 1.8 “Ngarkesa për Energji” nënkupton ngarkesën për njësi të furnizuar, të vlerësuar në përputhje me Kapitullin 7;

- 1.9 “Kostot e Energjisë” nënkupton kostot e lejuara për njësi të furnizuar të vendosur në përputhje me Kapitullin 4;
- 1.10 “EURIBOR” nënkupton Normën e Ofrimit për Depozita të Euros nga Federata Bankare Evropiane për periudhë 3 mujore, që paraqitet në faqen e caktuar të shërbimit të Reuters në ora 11:00 (kohë e matur sipas Kohës Qendrore Evropiane) ose, në rast se Reuters nuk vazhdon ta ofrojë këtë shërbim, cilado agjenci tjetër e pajtuar në mes të Gjeneratorit të Rregulluar dhe Rregullatorit. Për shmangje të dyshimit kjo do të jetë normë vjetore;
- 1.11 “Përshtatje e Jashtëzakonshme” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 6;
- 1.12 “Ngjarje e Jashtëzakonshme” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 7;
- 1.13 “Shqyrtim i Jashtëzakonshëm” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 7;
- 1.14 “Forcë Madhore” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 8;
- 1.15 “Ngarkesat e Gjeneratorit” nënkuptojnë Ngarkesat për Kapacitet dhe Ngarkesat për Energji që aplikohen nga Gjeneratori i Rregulluar;
- 1.16 “Taksa për Licencë” nënkupton shumën për pagesë sipas Nenit 7 të Pasqyrës së Taksave, që lëshohet nga Rregullatori dhe mund të amandamentohet;
- 1.17 “Kostot e Furnizimit me Thëngjill” nënkupton kostot e furnizimit të Gjeneratorit të Rregulluar me thëngjill, të përcaktuara në pajtim me Kapitullin 5;
- 1.18 “Rregullat e Tregut” ka kuptimin [do të definohej me rastin e përcaktimit të Rregullave të Tregut];
- 1.19 “Pragu i Materialitetit” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 6;
- 1.20 “Të Hyrat Maksimale të Lejuara” apo “MAR” nënkupton vlerën maksimale që mund të mbulohet brenda një Viti Relevant nga Gjeneratori i Rregulluar përmes Ngarkesës për Energji dhe Ngarkesës për Kapacitet, të Hyra këto që rregullohen përmes formulave të dhëna në Shtojcën 1 të kësaj Rregulle;
- 1.21 “E Matur” nënkupton çdo sasi të matur të energjisë elektrike, në pajtim me matësin e instaluar sipas Kodit të Matjes;
- 1.22 “MW” nënkupton megavat;
- 1.23 “MWh” nënkupton megavat-orë;
- 1.24 “Vlera Neto e Tanishme” nënkupton metodën e zhvlerësimit të rrjedhave të ardhshme të parasë;
- 1.25 “Propozim” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 4 paragrafin 4;
- 1.26 “Vendim i Përkohshëm” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 4 paragrafin 6;
- 1.27 “Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike” ose “PES” nënkupton bartësin e Licencës për Furnizim Publik;
- 1.28 “Shqyrtimi Periodik” nënkupton shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara të Gjeneratorit të Rregulluar për Periudhën Rregullative vijuese;

- 1.29 “Përshtatje e Rregullt” nënkupton përshtatjen Mekanike të Të Hyrave Maksimale të Lejuara që bëhet rreth fundit të çdo Viti Relevant;
 - 1.30 ‘Gjenerator i Rregulluar’ nënkupton Gjeneratorin që obligohet nga Ligji për Energji Elektrike të furnizojë FPEE-në me çmim të rregulluar në rastet kur nuk ka konkurrencë të mjaftueshme në tregun me shumicë dhe FPEE-ja kërkon që t’i përmbushë obligimet për furnizim;
 - 1.31 “Rregulatori” nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji;
 - 1.32 “Baza e Aseteve të Rregulluara” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 2;
 - 1.33 “Periudhë Rregullative” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 5 paragrafin 3;
 - 1.34 “Vit Relevant” nënkupton periudhën prej 12 muajsh në mes të Përshtatjeve të Rregullta;
 - 1.35 “Deklaratë për Parimet e Çmimvënies së Gjenerimit” nënkupton deklaratën e lëshuar nga Rregulatori me të cilën duhet të jenë në përputhje Ngarkesat e Rregulluara për Kapacitet dhe për Energji;
 - 1.36 “Deklaratë mbi Ndikimin Financiar” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 6;
 - 1.37 “Transitional Period” has the meaning given to it in 0;
 - 1.38 “Njësi e Furnizuar” nënkupton një kilovat-orë;
 - 1.39 “Njësitë e Furnizuara” nënkupton sasinë e gjithëmbarshme të energjisë elektrike që i faturohet FPEE-së për njësitë e furnizuara nga Rregulatori i Gjeneruar;
 - 1.40 “Mesatare e Ponderuar e Kostos së Kapitalit” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 3; dhe
 - 1.41 “X-faktori” nënkupton faktorin e përcaktuar në Shqyrtimet Periodike dhe të aplikuar në kostot e lejuara gjatë Përshtatjeve të Rregullta.
- 2 Termat e tjera të kësaj rregulle do ta kenë kuptimin që u është dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike apo në Ligjin për Energjinë.

KAPITULLI 2 NGARKESAT E GJENERATORËVE TË RREGULLUAR

Neni 4 Parimet e Përgjithshme

- 1 Ngarkesat Vjetore të Gjenerimit duhen caktuar ashtu që:
 - 1.1 Brenda çdo Viti Relevant, të hyrat që Gjeneratori i Rregulluar parashikon të mbledhë nga Ngarkesat për Kapciet janë të barabarta me Të Hyrat Maksimale të Lejuara (Kapitulli 3) të aprovuara nga Rregullatori;
 - 1.2 Brenda çdo Viti Relevant, të hyrat që Gjeneratori i Rregulluar parashikon të mbledhë nga Ngarkesat për Energji janë të barabarta me Kostot për Energji (Kapitulli 4) të aprovuara nga Rregullatori; dhe
 - 1.3 Narkesat për Gjeneratorin përcaktohen në pajtim me metodologjinë e zhvilluar nga Gjeneratori i Rregulluar dhe të aprovuar nga Rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në përputhje me Deklaratën për Parimet e Vënies së Çmimeve të Gjenerimit, të lëshuar nga Rregullatori.
- 2 Të Hyrat Maksimale të Lejuara përbëhen nga shuma e:
 - 2.1 Kostove të lejuara fikse të gjenerimit, duke përfshirë këtu kostot e lejuara fikse operative, zhvlerësimin e lejuar dhe kthimin e lejuar në kapital si komponenta fikse të furnizimit me lëndë të parë.
- 3 Kostot e Energjisë përbëhen nga shuma e:
 - 3.1 Kostot e lejuara operative variabile për çdo njësi të energjisë së furnizuar;
 - 3.2 Kostot e lejuara variabile të thëngjillit apo lëndës tjetër djegëse për çdo njësi të energjisë së furnizuar; dhe
 - 3.3 Taksën për Licenca.
- 4 Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Kostot e Energjisë do të përcaktohen si vijon:
 - 4.1 Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Kostot për Energji do të përcaktohen gjate Shqyrtimeve Periodike (Neni 5);
 - 4.2 Para përfundimit të çdo Viti Relevant do të aplikohet Përshtatja e Rregullt (Neni 6) që përfshin Përshtatjen mekanike të Të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Kostos së Energjisë për ndryshimet në kostot që konsiderohen të jenë jashtë kontrollit të Gjeneratorit të Rregulluar; dhe
 - 4.3 Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm (Neni 7) që përfshin përshtatjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe/ose Kostove të Energjisë për ndryshimet material në Kosto dhe/ose të Hyra që shkaktohen nga një Ngjarje e Jashtëzakonshme, do të realizohen sipas nevojës.
- 5 Periudha Tranzitore, e dhënë në Shtojcën 9, do të aplikohet deri më 31 mars 2016.

Neni 5 Shqyrtimet Periodike dhe Periudhat Rregullative

- 1 Gjatë Shqyrtimeve Periodike do të caktohen Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Kostot e Energjisë të Gjeneratorit të Rregulluar për Periudhën e ardhshme Rregullative.
- 2 Shqyrtimi Periodik do të mbahet para çdo Periudhe Rregullative.
- 3 Çdo Periudhë Rregullative do të zgjasë 5 vite, përveç:
 - 3.1 Gjatë Periudhës Tranzitore të dhënë në Shtojcën 9; dhe
 - 3.2 Në rast të pajtimit në mes të Gjeneratorit të Rregulluar dhe Rregullatorit, Periudha Rregullative mund të shkurtrohet apo zgjatet.
- 4 Procedura për mbarëvajtjen e Shqyrtimeve Periodike është dhënë në Shtojcën 4.

Neni 6 Përshtatjet e Rregullta

- 1 Gjatë Përshtatjeve të Rregullta do të llogariten ndryshimet e lejuara të të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe të Kostove të Energjisë.
- 2 Përshtatjet e Rregullta do të bëhen para çdo Viti Relevant vijues.
- 3 Ndryshimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe në Kostot e Energjisë gjatë çdo Përshtatjeje të Rregullt do të bazohet në:
 - 3.1 Nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara gjatë Vitit Relevant të tanishëm, për shkak të diferencave në mes të furnizimit të parashikuar të energjisë elektrike dhe furnizimit të realizuar të energjisë elektrike;
 - 3.2 Përshtatjet në Kostot e Energjisë për ndryshimet në Kostot e lëndës së parë apo në Kostot e parashikuara të Taksës për Licencë; dhe
 - 3.3 Nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e kostove të lejuara për Taksa të Licencës, për shkak të ndryshimeve në mes të kostove të parashikuara dhe atyre të realizuara.
- 4 Formulat për llogaritjen e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe të Kostove të Energjisë gjatë Përshtatjeve të Rregullta janë dhënë në Shtojcën 1.
- 5 Procedura për realizimin e Përshtatjeve të Rregullta është dhënë në Shtojcën 5.

Neni 7 Shqyrtimet e Jashtëzakonshme

- 1 Shqyrtimet e Jashtëzakonshme mund të shkaktohen nga Ngjarjet e Jashtëzakonshme, të definuara sipas Shtojcës 7.
- 2 Gjatë Shqyrtimeve të Jashtëzakonshme do të llogaritet ndikimi i Ngjarjes së Jashtëzakonshme në të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe në Kostot e Energjisë për pjesën e mbetur të Periudhës Rregullative. Nëse ndikimi është më i lartë se Pragu i Materialitetit, atëherë do të bëhet Përshtatje e Jashtëzakonshme në të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe në Kostot e Energjisë.
- 3 Llogaritja e ndikimit mbi të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe/ose në Kostot e Energjisë e Përshtatjes së Jashtëzakonshme nuk duhet të marrë parasysh faktorë të cilët nuk janë të ndërlidhur në mënyrë direkte me Ngjarjen e Jashtëzakonshme.

- 4 Për shmangje të dyshimit, Rregullatori do të marrë parasysh ndikimin e Ngjarjeve të Jashtëzakonshme (që e kalojnë Pragun e Materialitetit) në Shqyrtimet Periodike pasuese.
- 5 Procedura për mbarëvajtjen e Shqyrtimeve të Jashtëzakonshme është dhënë në Shtojcën 6.

KAPITULLI 3 TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA

Neni 8 Parimet e Përgjithshme

- 1 Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të caktohen në atë nivel që i mundësojnë Gjeneratorit të Rregulluar të caktojë Ngarkesat për Kapacitet në nivel që mundësojnë mbulimin e të gjitha kostot e furnizimit që nuk kanë të bëjnë me energji, përderisa këto kosto janë të arsyeshme dhe të vlerësuara me kujdes.
- 2 Kostot e arsyeshme që nuk kanë të bëjnë me energji të Gjeneratorit të Rregulluar do të përfshijnë:
 - 2.1 Kostot e lejuara të gjenerimit, duke përfshirë kostot e lejuara fikse operative (Neni 9), Zhvlerësimin e Lejuar (Neni 10) dhe Kthimin e Lejuar në Kapital (Neni 11). Gjatë Përshtatjeve të Rregullta, kostot e lejuara të gjenerimit do të përshtaten për të marrë parasysh inflacionin dhe për të zbritur X-faktorin;
 - 2.2 Komponentën fikse të Kostos së Furnizimit me Thëngjill (Neni 12), kur është e aplikueshme.
- 3 Në vlerësimin e kostove të arsyeshme, Rregullatori do të referohet në këta faktorë, por nuk është i kufizuar me ta:
 - 3.1 Performancën e kaluar;
 - 3.2 Performancën e parashikuar;
 - 3.3 Krahasimet me ndërmarrje të ngjashme në Kosovë dhe gjetiu në Evropë; dhe
 - 3.4 Krahasimet me kostot e aktiviteteve të ngjashme në Kosovë dhe gjetiu në Evropë.
- 4 Të Hyrat Maksimale të Lejuara nuk do të përfshijnë Të Hyrat nga burimet që janë të ndryshme nga furnizimi i energjisë elektrike për FPEE-në.
- 5 Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të shprehen me Euro (€).
- 6 Gjatë Rishikimeve Periodike, Rregullatori mund të përshtatë profilin e të Hyrave Maksimale të Lejuara që priten të mbulohen në çdo Vit Relevant në mënyrë që të minimizojë ndryshimet e menjëhershme të të Hyrave Maksimale të Lejuara.
- 7 Gjatë tërë kohës, Vlera Neto e Tanishme e të Hyrave Maksimale të Lejuara të parashikuara duhet të jetë e barabartë me Vlerën Neto të Tanishme të kostove të lejuara të parashikuara të Gjeneratorit të Rregulluar që priten të mbulohen nga Ngarkesat për Kapacitet. Kjo llogaritje e Vlerës Neto të Tanishme do të përdore Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit për Gjeneratorin e Rregulluar të vlerësuar nga ZRRE-ja, si normë diskontimi.
- 8 Formulatat për llogaritjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara janë dhënë në Shtojcën 1.

Neni 9 Kostot e Lejuara Fikse dhe Operative

- 1 Në dorëzimin e vlerësimeve për kostot operative fikse që duhen mbuluar nga Të Hyrat Maksimale të Lejuara për çdo Periudhë të Ardhshme Rregullative, Gjeneratori i Rregulluar nuk duhet të kërkojë mbulimin e ndonjë pjese apo të ndonjë elementi të kostos së korporatës, ndonjë kompanie amë apo kompanie degë që nuk mund t'i atribuohet në mënyrë të arsyeshme Gjeneratorit të Rregulluar.

Neni 10 Zhvlerësimi i Lejuar

- 1 Kostoja e zhvlerësimit do të llogaritet në mënyrë lineare si funksion i Jetëgjatësisë Ekonomike dhe Bazës së Aseteve të Rregulluara për kategori të ndryshme të asetëve, siç përshkruhet në Shtojcën 2.

Neni 11 Kthimi i Lejuar në Kapital

- 1 Kthimi i lejuar mbi koston e kapitalit do të llogaritet si funksion i Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit dhe Bazës së Aseteve të Rregulluara, siç përshkruhet në Shtojcën 2.
- 2 Kthimi në kapital do të llogaritet bazuar në vlerën e Bazës së Aseteve të Rregulluara në mes të çdo Viti Relevant (si mesatare e vlerës fillestare dhe vlerës përfundimtare së Bazës së Aseteve të Rregulluara).
- 3 Gjeneratori i Rregulluar nuk do të fitojë kthim të lejuar për asetet e financuara nga grantet kapitale.

Neni 12 Komponenta Fikse e Kostove të Furnizimit me Thëngjill

- 1 Komponenta fikse e Kostove të Furnizimit me Thëngjill do të llogaritet në përputhje me Kapitullin 5.

KAPITULLI 4 KOSTOT PËR ENERGJI

Neni 13 Parimet e Përgjithshme

- 1 Kostot për Energji do të caktohen në nivel që i mundëson Gjeneratorit të Rregulluar të caktojë Ngarkesat për Energji në nivel që lejojnë mbulimin e të gjitha kostove të arsyeshme të furnizimit me energji përderisa këto kosto janë të arsyeshme dhe të matura saktësisht.
- 2 Kostot e arsyeshme për energji të Gjeneratorit të Rregulluar do të përfshijnë:
 - 2.1 Kostot e lejuara të gjenerimit, duke përfshirë kostot e lejuara operative variabile (Neni 14). Gjatë përshtatjeve të Rregullta, kostot e lejuara të gjenerimit do të përshtaten për të marrë parasysh inflacionin dhe për të zbritur X-faktorin;
 - 2.2 Komponentën variabile e Kostove të Furnizimit me Thëngjill (Neni 15), kudo që është e aplikueshme;
 - 2.3 Kostot e tjera të furnizimit me lëndë djegëse që nuk janë thëngjill (Neni 16); dhe

- 2.4 Taksën për Licencë (Neni 17), që do të bartet plotësisht gjatë Përshtatjeve të Rregullta, duke supozuar se Taksa për Licencë shprehet si Euro për njësi të furnizuar (€/kWh).
- 3 Në vlerësimin e kostove të arsyeshme, Rregullatori do të referohet në këta faktorë, por nuk është i kufizuar me ta:
 - 3.1 Performancën e kaluar;
 - 3.2 Performancën e parashikuar;
 - 3.3 Krahasimet me ndërmarrje të ngjashme në Kosovë dhe gjetiu në Evropë; dhe
 - 3.4 Krahasimet me kostot e aktiviteteve të ngjashme në Kosovë dhe gjetiu në Evropë.
- 4 Kostot e energjisë nuk do të përfshijnë të Hyrat nga burime që ndryshojnë nga furnizimii Energjisë për FPEE-në.
- 5 Kostot e Energjisë do të shprehen në Euro për njësi të furnizuar (€/kWh).
- 6 Formulat për llogaritjen e Kostove të Energjisë janë dhënë në Shtojcën 1.

Neni 14 Kostot e Lejuara Operative Varibile

- 1 Në dorëzimin e vlerësimeve për kostot operative variabile që duhen mbuluar nga Të Hyrat Maksimale të Lejuara për çdo Periudhë të Ardhsme Rregullative, Gjeneratori i Rregulluar nuk duhet të kërkojë mbulimin e ndonjë pjese apo të ndonjë elementi të kostos së korporatës, ndonjë kompanie amë apo kompanie degë që nuk mund t'i atribuohet në mënyrë të arsyeshme Gjeneratorit të Rregulluar.

Neni 15 Komponenta Variabile e Kostos së Furnizimit me Thëngjill

- 1 Komponenta variabile e Kostos së Furnizimit me thëngjill do të llogaritet në përputhje me Kapitullin 5.

Neni 16 Kostot e tjera të furnizimit me lëndë djegëse

- 1 Furnizimi i nevojshëm i lëndës djegëse që nuk është thëngjill do të llogaritet në bazë të konsumit specifik për çdo njësi të energjisë së furnizuar.
- 2 Kostoja e lëndës djegëse që nuk është thëngjill do të llogaritet duke marrë parasysh:
 - 2.1 Koston e realizuar të furnizimit me lëndë djegëse që nuk është thëngjill; dhe
 - 2.2 Çmimet kombëtare, regionale dhe ndërkombëtare të lëndës djegëse.
- 3 Kostoja e furnizimit me lëndë djegëse që nuk është thëngjil do të përshtatet për të marrë parasysh ndryshimet në çmimet e kësaj lënde djegëse gjatë çdo Përshtatjeje të Rregullt, sipas formualve të dhëna në Shtojcën 1.

Neni 17 Pass-Through of Licence Fee

- 1 Gjeneratori i Rregulluar do të bartë koston e Taksës së Licencës. Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të përshtaten për të reflektuar ndryshimet në Taksën e Licencës në çdo Përshtatje të Rregullt, sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1.

KAPITULLI 5 KOSTOT E FURNIZIMIT ME THËNGJILL

Neni 18 Parimet e Përgjithshme

- 1 Kostot e Furnizimit me Thëngjill do të mbulojnë koston e furnizimit me thëngjill të Gjeneratorit të Rregulluar.
- 2 Në rast të ekzistimit të marrëveshjes për furnizim me thëngjill, Kostot e Furnizimit me Thëngjill do të përcaktohen në përputhje me marrëveshjen në fjalë dhe ndarja në mes të kostove fikse dhe kostove variable do të vendoset në përputhje me këtë marrëveshje.
- 3 Në rastet kur nuk ka marrëveshje për furnizim me lëndë djegëse, Kostot e Furnizimit me Thëngjill do të llogariten me supozimin se kompania e mihjeve është kompani e pavarur.
- 4 Në këto raste, Kostot e Furnizimit me Thëngjill do të përcaktohen në të njëjtën mënyrë si kostot e lejuara të Gjeneratorit të Rregulluar (Kapitulli 3 dhe Kapitulli 4) dhe kostot do të alokohen në mes të komponentave fikse dhe komponentave variable në të njëjtën mënyrë.

KAPITULLI 6 NGARKESAT PËR KAPACITET

Neni 19 Parimet Themelore

- 1 Ngarkesat për Kapacitet do të caktohen kohë pas kohe në mënyrë që:
 - 1.1 Ngarkesa për Kapacitet do të mbulojë Të Hyrat Maksimale të Lejuara për Gjeneratorin e Rregulluar, në qoftë se kapaciteti gjenerues në dispozicion e plotëson Cakun e Disponueshmërisë; dhe
 - 1.2 Ngarkesa për Kapacitet është në përputhje me Metodologjinë e zhvilluar nga Gjeneratori i Rregulluar dhe të aprovuar nga Rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në pajtim me Deklaratën për Parimet e Vënies së Çmimeve për Gjenerim, të lëshuar nga Rregullatori.
- 2 Ngarkesa për Kapacitet do të shprehet në Euro për njësi të kapacitetit në dispozicion për [orë] (€/kW/[orë]).
- 3 Rregullatori do të caktojë Cakun e Disponueshmërisë së kapaciteteve gjeneruese brenda çdo viti, që do të përdoret për të llogaritur Ngarkesën për Kapacitet, që do të marrë parasysh:
 - 3.1 Performancën e kaluar;
 - 3.2 Performancën e parashikuar; dhe
 - 3.3 Krahasimet me gjenerator të krahasueshëm në Kosovë dhe gjetiu në Evropë.

- 4 The Regulator shall define the procedures for testing of capacity availability as required.

Neni 20 Procedura e Aprovimit të Ngarkesëve për Kapacitet

- 1 Gjeneratori i Rregulluar do të dorëzoj tek Rregullatori Metodologjinë për Ngarkesat për Kapacitet dhe çdo amendamentim të nevojshëm vijues në këtë Metodologji së paku [30 Ditë Pune] para datës së propozuar të hyrjes në fuqi.
- 2 Asnjë Metodologji apo amendamentim i Metodologjisë nuk do të jetë efektiv pa aprovim të Rregullatorit.
- 3 Gjeneratori i Rregulluar do të ketë të drejtë të përcaktojë Ngarkesat për Kapacitet, me kusht që ato janë në përputhje me kërkesat e Nenit 19 dhe me kusht që ato të jenë të aprovuara nga Rregullatori.
- 4 Palët duhet të kenë të drejtë të apelojnë te Rregullatori rreth Ngarkesave për Kapacitet që u aplikohen atyre, sipas legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI 7 NGARKESAT PËR ENERGJI

Neni 21 Parimet Themelore

- 1 Ngarkesat për Energji do të caktohen kohë pas kohe ashtu që:
- 1.1 Ngarkesat për Energji mbulojnë Kostot për Energji të Gjeneratorit të Rregulluar; dhe
- 1.2 Ngarkesat për Energji janë në pajtim me Metodologjinë e zhvilluar nga Gjeneratori i Rregulluar që aprovet nga Rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në përputhje me Deklaratën për Vënien e Çmimeve të Gjenerimit, të lëshuar nga Rregullatori.
- 2 Ngarkesat për Energji do të shprehen në Euro për çdo njësi të energjisë së furnizuar (€/kWh).

Neni 22 Procesi i Aprovimit të Ngarkesave për Energji

- 1 Gjeneratori i Rregulluar do të dorëzojë te Rregullatori Metodologjinë për Ngarkesat për Energji dhe çdo amendamentim pauses të kësaj Metodologjie së paku [30 Ditë Pune] para datës së propozuar të hyrjes në fuqi.
- 2 Asnjë Metodologji apo amendamentim i Metodologjisë nuk do të jetë efektiv pa aprovim të Rregullatorit.
- 3 Gjeneratori i Rregulluar do të ketë të drejtë të përcaktojë Ngarkesat për Energji, me kusht që ato janë në përputhje me kërkesat e Nenit 21 më lartë dhe me kusht që ato të jenë të aprovuara nga Rregullatori.
- 4 Palët duhet të kenë të drejtë të apelojnë te Rregullatori rreth Ngarkesave për Energji që u aplikohen atyre, sipas legjislacionit në fuqi.

SHTOJCA 1**TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA DHE LLOGARITJA E KOSTOS SË ENERGJISË**

1 Kjo Shtojcë paraqet formulat për llogaritjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe të Kostove të Energjisë të Gjeneratorit të Rregulluar. Kjo Shtojcë ka për qëllim të komplementojë parimet e përcaktuara në pjesën kryesore të Rregullës.

2 Të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) do të llogariten sipas formulës në vijim:

$$MAR_t = NENR_t + KREV_t$$

Ku

MAR_t paraqet Të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vitin Relevant t

$NENR_t$ është pjesa e të Hyrave që nuk ka të bëjë me energjinë në Vitin Relevant t , që caktohet gjatë Shqyrtimit Periodik ashtu që Vlera Neto e Tanishme (përgjatë Periudhës Rregullative dhe duke marrë parasysh X-faktorin) të jetë e barabartë me Vlerën Neto të Tanishme të kostove të parashikuara që nuk kanë të bëjnë me energjinë

$KREV_t$ paraqet të Hyrat nga faktori korrigjues në Vitin Relevant t , që parashihet të jetë Zero gjatë Shqyrtimeve Periodike

2.1 Të Hyrat e Lejuara që nuk kanë të bëjnë me energjinë ($NENR_t$) do të llogariten gjatë Përshtatjeve të Rregullta duke përdorur formulën në vijim:

$$NENR_t = NENR_{t-1} * (1 + CPI_{t-1} - X_t)$$

Ku

$NENR_t$ paraqet të hyrat e lejuara që nuk kanë të bëjnë me energjinë në Vitin Relevant t

$NENR_{t-1}$ paraqet të hyrat e lejuara që nuk kanë të bëjnë me energjinë në Vitin Relevant $t-1$, përveç në vitin Relevant 1 kur kjo do të jetë një vlerë e caktuar nga Rregullatori në Shqyrtimin në të afërt Periodik

CPI_{t-1} është vlera e realizuar e inflacionit në Vitin Relevant $t-1$, matur duke përdorur Indeksin e Harmonizuar të çmimeve të Konsumit (HICPs) – për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat-i

X_t është X-faktori në Vitin Relevant t , që caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike

2.2 Faktori i përshtatjes së të Hyrave ($KREV_t$) do të llogaritet gjatë Përshtatjeve të Rregullta duke përdorur formulën në vijim:

$$KREV_t = (MAR_{t-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku

ARR_{t-1} paraqet të Hyrat Aktuale të Rregulluara në Vitin Relevant $t-1$

MAR_{t-1} paraqet të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vitin Relevant $t-1$

I_t është norma e interesit për Vitin Relevant t që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 1%

3 Kostoja për Energji (ENC_t) do të llogaritet duke përdorur formulën në vijim:

$$ENC_t = LIGV_t + FUEL_t + VOM_t + LICC_t$$

Ku

ENC_t është kostoja e lejuar e Energjisë në Vitin Relevant t (shprehur në €/kWh)

$LIGV_t$ është pjesa variabile e Kostove të Furnizimit me Thëngjill në Vitin Relevant t (në €/kWh ku njësia ka të bëjë me njësitë e furnizuara nga Gjeneratori i Rregulluar)

$FUEL_t$ paraqet koston e furnizimit me lëndë djegëse që nuk është thëngjill në Vitin Relevant t (në €/kWh ku me “njësi” nënkuptojmë njësitë e furnizuara nga Gjeneratori i Rregulluar)

VOM_t paraqet kostot operative variabile të lejuara në Vitin Relevant t (të shprehur në €/kWh)

$LICC_t$ është Taksa për Licencë në Vitin Relevant t (shprehur në €/kWh)

3.1 Pjesa variabile e Kostove të Furnizimit me Thëngjill ($LIGV_t$) do të llogaritet gjatë Përshtatjeve të Rregullta duke përdorur formulën në vijim:

$$LIGV_t = LIGV_{t-1} * (1 + CPI_{t-1} - Y_t)$$

Ku

$LIGV_t$ është pjesa e variabile e lejuar e Kostove të Furnizimit me Thëngjill në Vitin Relevant t

$LIGV_{t-1}$ është pjesa e variabile e lejuar e Kostove të Furnizimit me Thëngjill në Vitin Relevant $t-1$ përveq në Vitin Relevant 1 kur do të përdoret një vlerë e përcaktuar nga Rregullatori gjatë Shqyrtimit më të vonshëm Periodik

CPI_{t-1} është vlera e realizuar e inflacionit në Vitin Relevant $t-1$, matur duke përdorur Indeksin e Harmonizuar të çmimeve të Konsumit (HICPs) – për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat-i

Y_t paraqet përmirësimet e parashikuara në efikasitet të kostove variabile të kompanisë së mihjes, që përcaktohet nga Rregullatori në Shqyrtimin më të vonshëm Periodik (shprehur në %)

3.2 Kostoja e lëndës djegëse që nuk është thëngjill ($FUEL_t$) do të llogaritet gjatë Përshtatjeve të Rregullta duke përdorur formulën në vijim:

$$FUEL_t = \sum FUEL_{j,t}$$

$$FUEL_{j,t} = FUPR_{j,t} * FUCO_j$$

$$FUPR_{j,t} = FUPR_{j,t-1} * (1 + FPI_{j,t})$$

Ku

$FUEL_t$	<i>paraqet koston e lejuar të furnizimit me lëndë djegëse që nuk është thëngjill në Vitin Relevant t</i>
$FUEL_{j,t}$	<i>paraqet koston e furnizimit me lëndë djegëse për lëndën djegëse j në Vitin Relevant t</i>
$FUPR_{j,t}$	<i>paraqet çmimin e lejuar për furnizim me lëndën djegëse j në Vitin Relevant t</i>
$FUCO_j$	<i>paraqet konsumin specific të lëndës djegëse j, siç përcaktohet nga Rregullatori në Shqyrtimin më të vonshëm Periodik (shprehur si njësi e lëndës djegëse në raport me njësinë e furnizuar nga Gjeneratori i Rregulluar)</i>
$FUPR_{j,t-1}$	<i>paraqet çmimin e lejuar për furnizim me lëndën djegëse j në Vitin Relevant t-1, përveq në Vitin Relevant 1 kur do të përdoret vlera e përcaktuar nga ZRRE në Shqyrtimin më të vonshëm Periodik (shprehur në €/njësi lëndë djegëse)</i>
$FPI_{j,t}$	<i>paraqet ndryshimin vjetor të indeksit të çmimit për blerjen e lëndës djegëse j, siç përcaktohet nga Rregullatori në Shqyrtimin më të vonshëm Periodik (shprehur në %)</i>

- 3.3 Kostot variabile operative (VOM_t) do të llogariten gjatë Përshtatjeve të Rregullta sipas formulës:

$$VOM_t = VOM_{t-1} * (1 + CPI_{t-1} - Z_t)$$

Ku

VOM_t	<i>paraqet koston variabile operative në Vitin Relevant t</i>
VOM_{t-1}	<i>paraqet koston variabile operative në Vitin Relevant t -1 përveq në Vitin Relevant 1 kur do të përdoret vlera e përcaktuar nga ZRRE në Shqyrtimin më të vonshëm Periodik</i>
CPI_{t-1}	<i>është vlera e realizuar e inflacionit në Vitin Relevant t-1, matur duke përdorur Indeksin e Harmonizuar të çmimeve të Konsumit (HICPs) – për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat-i</i>
Z_t	<i>paraqet përmirësimet e parashikuara në efiqencë të kostove operative variabile të kompanisë së mihjes, që përcaktohet nga Rregullatori në Shqyrtimin më të vonshëm Periodik (shprehur në %)</i>

- 3.4 Taksa për Licencë ($LICC_t$) do të llogaritet gjatë Përshtatjeve të Rregullta sipas formulës:

$$LICC_t = LICCF_t + (LICC_{a,t-1} - LICCF_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku

$LICC_t$	<i>është Taksa për Licencë në Vitin Relevant t</i>
----------	--

$LICC_t$	është taksa e parashikuar për Licencë për Vitin Relevant t
$LICCa_{t-1}$	është Taksa e realizuar për Licencë në Vitin Relevant $t-1$
$LICCf_{t-1}$	është Taksa e parashikuar për Licencë në Vitin Relevant $t-1$
I_t	është norma e interesit për Vitin Relevant t që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 1%

SHTOJCA 2

BAZA E ASETEVE TË RREGULLUARA

- 1 Kjo Shtojcë përshkruan vlerësimin e Bazës së Aseteve të Rregulluara për qëllime të llogaritjes së Zhvlerësimit të lejuar (Neni 10) si dhe kthimit të lejuar në kapital (Neni 11).
- 2 Baza e Aseteve të Rregulluara do të jetë vlerë rregullative e shumës së asetëve të përdorura dhe të përdorshme të Gjeneratorit të Rregulluar. Baza e Aseteve të Rregulluara do të ndahet kategoritë e ndryshme të asetëve.
- 3 Baza e Aseteve të Rregulluara do të azhurnohet në çdo Shqyrtim Periodik si më poshtë:
 - 3.1 Kostoja e lejuar e zhvlerësimit gjatë Periudhës Rregullative të tanishme do të zbritet nga Baza e Aseteve të Rregulluara dhe do të llogaritet në mënyrë linear duke përdorur Jetëgjatësinë Ekonomike;
 - 3.2 Shitjet e asetëve gjatë Periudhës së tanishme Rregullative do të zbriten nga Baza e Aseteve të Rregulluara bazuar në vlerën rregullative. Ndryshimi në mes të vlerës së shitur dhe vlerës rregullative do të zbritet nga të Hyrat Maksimale të Lejuara për Periudhën e ardhshme Rregullative;
 - 3.3 Shpenzimet e aprovuara kapitale gjatë Periudhës së tanishme Rregullative do t'i shtohen Bazës së Aseteve të Rregulluara nga data kur asetë vihet në shërbim dhe në koston e aprovuar në Planin e Aprovuar të Investimeve. Interesi gjatë ndërtimit do të kapitalizohet. Për shmangje të dyshimit, Rregullatori nuk do të bëjë reduktime retroaktive të të Hyrave në të ardhmen për të marrë parasysh ndryshimin në mes të kostos aktuale dhe koston së aprovuar të investimit. Megjithatë, Rregullatori do të marrë parasysh koston aktuale për Shqyrtimet e më vonshme Periodike si masë për parashikimin e investimeve në të ardhmen;
 - 3.4 Nëse një projekt kapital i aprovuar në Planin e Aprovuar Investiv nuk sillet në shërbim gjatë Periudhës Rregullative në fjalë, kostoja e tij nuk i shtohet Bazës së Aseteve të Rregulluara në Shqyrtimin vijues Periodik dhe të gjitha të Hyrat e përfituara nga asetë do të zbriten në Shqyrtimin e ardhshëm Periodik;
 - 3.5 Kurdo që kostoja e mirëmbajtjes është apo ka qenë më herët e përfshirë në shpenzimet e lejuara operative, nuk do të lejohet të kapitalizohet apo të përfshihet në Bazën e Aseteve të Rregulluara; dhe
 - 3.6 Baza e Aseteve të Rregulluara do të përshtatet për të marrë parasysh inflacionin përgjatë Periudhës së kaluar Rregullative, duke përdorur Indekset e Harmonizuara të çmimeve të konsumit për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat.
- 4 Jetëgjatësia Ekonomike e asetëve për kategori të ndryshme të asetëve do të përdoret për të llogaritur zhvlerësimin në Bazën e Aseteve të Rregulluara. Jetëgjatësia ekonomike do të vlerësohet gjatë Shqyrtimeve Periodike për të reflektuar jetëgjatësinë teknike të asetëve, përveç në rastet ku mund të dëshmohet se jetëgjatësia teknike ndryshon nga jetëgjatësia ekonomike e asetit.
- 5 Investimet kapitale të aprovuara do të vlerësohen gjatë Shqyrtimeve Periodike bazuar në Planin e Aprovuar Investiv për Shqyrtimin Periodik vijues. Plani i Aprovuar Investiv do të:
 - 5.1 Përfshijë projektet kapitale të cilat janë të nevojshme për të ofruar furnizim;

- 5.2 Identifikojë çdo projekt kapital të renditur sipas prioritetit;
 - 5.3 Tregojë përfitimin e Konsumatorëve të Rregulluar nga çdo projekt kapital;
 - 5.4 Ketë parasysh planet tjera investive apo zhvillimore të Gjeneratorit të Rregulluar që janë aprovuar nga Rregullatori (dhe çdo ndryshim në mes të këtyre planeve duhet të identifikohet dhe të sqarohet nga Gjeneratori i Rregulluar); dhe
 - 5.5 Zhvillohet duke përdorur teknika të diskontimit të rrjedhës së parasë.
- 6 Plani i Aprovuar Investiv do të implementohet si më poshtë:
- 6.1 Gjeneratori i Rregulluar do të përdorë të gjitha metodat e arsyeshme për të siguruar implementimin e Planit të Aprovuar Investiv në kohën dhe sipas orarit të aprovuar;
 - 6.2 Nëse Gjeneratori i Rregulluar, për arsye jashtë kontrollit të tyre, dështon në implementimit të investimeve kapitale në pajtim me orarin e dhënë në Planin e Aprovuar Investiv, atëherë Gjeneratori i Rregulluar duhet ta njoftojë Rregullatorin. Gjeneratori i Rregulluar duhet të japë arsye të detajuara për vonesën së bashku me orarin e ri;
 - 6.3 Gjeneratori i Rregulluar mund të aplikojë në çdo kohë te Rregullatori për të zëvendësuar një projekt kapital në Planin e Aprovuar Investiv me ndonjë projekt tjetër kapital në rastet kur mund të dëshmohet se projekti alternativ do të sjellë përfitime të njëjta apo më të mira për konsumatorët se projekti fillestar (duke marrë parasysh rezultatet e pritura dhe kostot). Nëse Rregullatori e aprovon zëvendësimin, projekti alternativ do t'i shtohet Bazës së Aseteve të Rregulluara në Shqyrtimin Periodik të ardhshëm. Për shmangje të dyshimit, të Hyrat Maksimale të Lejuara për periudhën e tanishme nuk do të përshtaten; dhe
 - 6.4 Nëse Gjeneratori i Rregulluar e zëvendëson një projekt kapital në Planin e Aprovuar Investiv me një projekt alternativ para se të marrë Arovimin e Rregullatorit, Rregullatori do të konsiderojë aprovimin e zëvendësimit në Shqyrtimin Periodik vijues por kjo nuk është obligative për Rregullatorin.
- 7 Me qëllim të përcaktimit të Kostove të Lejuara të Thëngjilli në rastet kur nuk ka marrëveshje për furnizim me thëngjill, Gjeneratori do të përcaktojë Bazën e Rregulluar të Aseteve për kompaninë e furnizimit me thëngjill në të njëjtën mënyrë siç është përshkruar më lartë, me këto përjashtime:
- 7.1 Rregullatori do të konsultohet me Operatorin e Licencuar për planin e tyre të propozuar investiv por Rregullatori nuk ka mandat të kërkojë dorëzimin e këtyre planeve apo të bëjë aprovimin e tyre;
 - 7.2 Bazuar në këto konsultime, Rregullatori do të përgatisë parashikimet për nevojat e investimeve në kompaninë e mihjeve për qëllim të përcaktimit të Kostove të Lejuara për Thëngjill; dhe
 - 7.3 Rregullatori do t'i përdorë informatat për shtesat dhe fshirjet e asetëve nga pasqyrat financiare të kompanisë së mihjeve me qëllim të azhurnimit të Bazës së Aseteve të Rregulluara pas çdo Shqyrtimi Periodik.

Komenti 1: ZRRE nuk e licencon kompaninë e Mihjeve dhe për këtë arsye nuk mund ta detyrojë atë t'i japë informata ZRRE-së.

SHTOJCA 3

MESATARJA E PONDERUAR E KOSTOS SË KAPITALIT

- 1 Mesatarja e Ponderuar e Kosos së Kapitalit do të llogaritet para taksave sipas formulës:

$$WACC = (1 - gi) * (rEi) / (1 - t) + gi * (rDi)$$

Ku

WACC është Mesatarja e Ponderuar e Kosos së Kapitalit

gi gearing (norma borxh:ekuitet) për firmën *i*

rEi kostoja reale e ekuitetit (shprehur si %) për firmën *i*

rDi kostoja reale e borxhit (shprehur si %) për firmën *i*

t norma e tatimit mbi korporatat në Kosovë

- 2 Gearing (g) do të jetë vlerë e caktuar nga Rregullatori në mes të 0 dhe 1 dhe përfaqëson pjesëmarrjen e borxhit në financimin e përgjithshëm. Vlera do të vlerësohet duke marrë parasysh financimin aktual të Gjeneratorit të Rregulluar, financimin që është i pritshëm për biznese të ngjashme si dhe përbërjen e financimit të kompanive të ngjashme ndërkombëtare.

- 3 Kostoja e Ekuitetit (rEi) do të jetë vlerë e llogaritur nga Rregullatori duke përdorur Modelin për Vënien e Çmimeve të Aseteve Kapitale (CAPM) me formulën në vijim:

$$rEi = rf + \beta_i * ERPm$$

rf është norma pa risk

ERPm është premia për riskun në ekuitet që i aplikohet tërë tregut

βi kovarianca në mes të kthimeve të asetit të ekuitetit në fjalë dhe të aseteve të tërë tregut (beta e ekuitetit)

- 3.1 Norma pa risk (rf) paraqet koston e borxhit në Kosovë, në terma reale, dhe do të caktohet nga Rregullatori duke përdorur të dhëna nga kostoja e borxhit në Kosovë ose, në rast të mungesës së kësaj informate, koston e borxhit në shtete të cilat kanë status të njëjtë kreditor me Kosovën.
- 3.2 Premia e riskut mbi ekuitetin (ERPm) përcaktohet nga Rregullatori duke përdorur të dhëna nga premia e riskut ndërkombëtar mbi ekuitetin.
- 3.3 Beta (βi) do të përcaktohet nga Rregullatori duke përdorur të dhëna mbi betat e aplikuarra për kompani të krahasueshme ndërkombëtarisht.
- 4 Kostoja e Borxhit (rDi) do të jetë mesatarja e normave të interesit për kreditë ekzistuese afatgjata (që kalojnë 1 vit) për Gjeneratorin e Rregulluar, shprehur në terma reale dhe ponderuar sipas vlerës në Euro të secilës kredi.
- 4.1 Gjeneratori i Rregulluar është i obliguar të prokurojë huatë përmes procedurave të konkurrencës ose të demonstrojë pranë Rregullatorit se norma e interesit për huatë e

marra pa prokurim është e barabartë me, ose më e ulët se, normat e interesit në treg në kohën kur është nënshkruar marrëveshja.

- 4.2 Kur Rregullatori konsideron se norma e interesit për një hua të marrë pa prokurim komercial e tejkalon normën e interesit të tregut, atëherë ajo hua do të përjashtohet nga llogaritja e kostos së borxhit.
- 4.3 Kur Rregullatori konsideron se ka numër të pamjaftueshëm të huave për të arritur në një vlerësim të kostos së huamarrjes për OSSH-në, Rregullatori mund të përshtatë koston e Borxhit të llogaritur si më lartë. Kjo përshtatje do të bazohet në:
 - (i) Vlerësimin e normës së interesit në treg për hua ndaj bizneseve me madhësi, risk dhe status kreditor të ngjashëm me Gjeneratorin e Rregulluar.
 - (ii) Vlerësimin e normës së parashikuar të interesit për huatë potenciale koncesionare të Gjeneratorin e Rregulluar.
 - (iii) Vlerësimin e përbërjes së parashikuar të huave komerciale (jo koncesionare) dhe koncesionare në borxhin e Gjeneratorit të Rregulluar për Periudhën e ardhshme Rregullative.
- 5 Për qëllime të përcaktimit të Kostove të lejuara të Furnizimit me Thëngjill, në rastet kur nuk ekziston marrëveshja për furnizim me thëngjill, Rregullatori do të vlerësojë Mesataren e Ponderuar të Kostos së kapitalit në të njëjtën mënyrë si më lart, me këto përjashtime:
 - 5.1 Rregullatori do të konsultohet me kompaninë e mihjeve rreth koston e tyre të financimit;
 - 5.2 Meqë rregullatori nuk ka mandat ligjor të kërkojë që operator i licencuar të prokurojë huatë përmes procedurave konkurruese, Rregullatori do të përcaktojë koston e borxhit të operatorit të licencuar duke përdorur parimet e dhëna në 4.3 të kësaj Shtojce; dhe
 - 5.3 Gjatë kësaj llogaritjeje, Rregullatori do të marrë parasysh çdo evidencë mbi koston e realizuar të financimit që i dorëzohet nga operator i licencuar.

SHTOJCA 4

PROCESI I SHQYRTIMIT PERIODIK

- 1 Me qëllim të ngritjes së transparencës, Rregullatori do të publikojë në ueb-faqen zyrtare të gjitha dokumentet e dorëzuara, komentet dhe dokumentet tjera relevante të pranuar nga Gjeneratori i Rregulluar apo palët e tjera të interesit që kanë të bëjnë me Shqyrtimin Periodik brenda [5 ditëve të punës] pas pranimit të informatave të dorëzuara nga Gjeneratori i Rregulluar, duke mos përfshirë këtu informatat që Rregullatori i konsideron komercialisht konfidenciale.
- 2 Rregullatori do të iniciojë Shqyrtimin Periodik jo më vonë se [gjashtë muaj] para fillimit të Periudhës së ardhshme Rregullative. Një orar tjetër do të vlejë gjatë Periudhës Tranzitore të dhënë në Shtojcën 9.
- 3 Rregullatori do të iniciojë Shqyrtimin Periodik duke njoftuar Gjeneratorin e Rregulluar lidhur me:
 - 3.1 Vitet për të cilat kërkohen të dhënat për vitin aktual dhe parashikimet për të ardhmen;
 - 3.2 Formatin me anë të të cilit këto të dhëna do të dorëzohen;
 - 3.3 Orarin për dorëzimin e propozimit të Gjeneratorit të Rregulluar për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Shqyrtimin e ardhshëm Periodik; dhe
 - 3.4 Orarin për procesin e përgjithshëm të shqyrtimit.
- 4 Propozimi i Gjeneratorit të Rregulluar do të përmbajë informacionin e mëposhtëm dhe do të adresojë çështjet në vijim (pa kufizim):
 - 4.1 Të Hyrat Aktuale të Rregulluara të mbledhura gjatë Periudhës së tanishme Rregullative (duke përdorur një vlerësim të arsyeshëm për muajt e mbetur kur është e nevojshme);
 - 4.2 Koston e realizuar për ofrimin e furnizimit gjatë Periudhës së tanishme Rregullative, në linjë me definicionet e koston që janë përdorur për llogaritjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Kostove të Energjisë;
 - 4.3 Kostot e realizuara të Furnizimit me Thëngjill gjatë Periudhës së tanishme Rregullative;
 - 4.4 Raportin vjetor dhe pasqyrat financiare të audituara për çdo vit fiskal që ka përfunduar në Periudhën e tanishme Rregullative;
 - 4.5 Nivelin e realizuar të kapacitetit në dispozicion si dhe njësitë e furnizuara gjatë Periudhës së tanishme Rregullative;
 - 4.6 Parashikimin për Kapacitetin në Dispozicion dhe njësitë e furnizuara për Periudhën e ardhshme Rregullative;
 - 4.7 Parashikimin për Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Kostot e Energjisë, duke raportuar ndaras për secilën komponentë të koston, për Periudhën e ardhshme Rregullative;

- 4.8 Kostot e parashikuara për Furnizim me Thëngjill për Periudhën e ardhshme Rregullative; dhe
- 4.9 Çdo material tjetër që Rregullatori konsideron se duhet të përfshihet në propozimin e Gjeneratorit të Rregulluar në rastet kur Rregullatori e ka njoftuar paraprakisht dhe me kohë të mjaftueshme Gjeneratorin e Rregulluar për afatin e dorëzimit të propozimit të tyre.
- 5 Gjatë përgatitjes së Propozimit të saj, Gjeneratori i Rregulluar do të aplikojë plotësisht Metodologjinë e zbatuar në këtë Rregull. Gjeneratori i Rregulluar do të deklarojë të gjitha vendet ku nuk është aplikuar kjo Metodologji, arsyet për mos-aplikimin e metodologjisë, arsyet që përkrahin qasjen alternative dhe vlerësimin e ndikimit të përdorimit të qasjes alternative.
- 6 Pas marrjes së Propozimit të Gjeneratorit të Rregulluar, Rregullatori do të vlerësojë saktësinë, relevancën dhe arsyeshmërinë e saj duke aplikuar metodologjinë e kësaj Rregulle, duke përfshirë këtu vlerësimin se a reflektojnë Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Kostot e Energjisë koston e arsyeshme për ofrimin e Shërbimeve të Furnizimit.
- 7 Rregullatori do të përgatisë një Vendim të Përkohshëm jo më vonë se [50 ditë pune] para fillimit të Periudhës së ardhshme Rregullative, pas konsultimit me Gjeneratorin e Rregulluar. Propozimi i Përkohshëm do të paraqesë propozimet e Rregullatorit për Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Kostot e Energjisë që do të mbulohen nga Gjeneratori i Rregulluar gjatë Periudhës Rregullative si dhe justifikimin për këtë propozim. Rregullatori mund të amandamentojë, ndryshojë apo fshijë cilëndo pjesë të Propozimit të Gjeneratorit të Rregulluar sipas vlerësimit të tij në rastet kur Rregullatori ofron justifikim për këto amandamentime, zhvendosje apo fshirje.
- 8 Në të njëjtën kohë, pas marrjes së Vendimit të Përkohshëm, Rregullatori do të fillojë procesin e konsultimit publik mbi Vendimin Fillestar në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
- 9 Pas përfundimit të konsultimit publik dhe jo më vonë se [20 Ditë Pune] para fillimit të Periudhës së Ardhshme Rregullative, Rregullatori duhet të marrë Vendimin Final për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Periudhën e ardhshme Rregullative. Vendimi i Rregullatorit do të jetë në pajtueshmëri me këtë Rregull.
- 10 Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Kostot e Energjisë të dhëna në Vendimin Final të Rregullatorit do të aplikohen nga data e fillimit të Periudhës së ardhshme Rregullative.
- 11 Gjeneratori i Rregulluar mund të apelojë vendimin e Rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

SHTOJCA 5

PROCESI I PËRSHTATJEVE TË RREGULLTA

- 1 Gjeneratori i Rregulluar do të dorëzojë te Rregullatori propozimin për Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Kostot e Energjisë për Vitin e ardhshëm Relevant së paku [20 Ditë Pune] para fillimit të Vitit të ardhshëm Relevant. Gjeneratori i Rregulluar po ashtu do të përfshijë në këtë dorëzim edhe dokumentet relevante dhe evidencën përfshirë vlerat që kanë të bëjnë me komponentët e formulave të Përshtatjeve të Rregullta të dhëna në Kapitullin 7 si dhe çdo informatë tjetër të kërkuar nga Rregullatori.
- 2 Rregullatori mund të kërkojë nga Gjeneratori i Rregulluar që të japë sqarime shtesë për metodën e llogaritjes së propozimit për Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Kostove të Energjisë dhe, në këto raste, Gjeneratori i Rregulluar do të ofrojë, brenda një periudhe të shpejtë kohore, të gjitha informatat e kërkuara nga Rregullatori..
- 3 Rregullatori do ta informojë Gjeneratorin e Rregulluar së paku [5 Ditë Pune] para fillimit të Vitit të Ardhshëm Relevant nëse e aprovon llogaritjen e Gjeneratorit të Rregulluar për të Hyrat Maksimale dhe Koston e Energjisë të propozuara.
- 4 Nëse Rregullatori e aprovon propozimin për Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Koston e Energjisë , atëherë këto do të jenë Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Kostoja e Energjisë për Vitin e ardhshëm Relevant.
- 5 Nëse Rregullatori nuk e aprovon propozimin për të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Koston e Energjisë, Rregullatori do të japë arsyetim dhe evidencë për këtë, në pajtim me këtë Rregull. Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Kostoja e Energjisë nuk do të ndryshojnë deri sa Rregullatori të aprovojë një propozim alternativ ose të ofrojë llogaritjen për Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Koston e Energjisë.
- 6 Çdo ndryshim në të Hyra që mund të rezultojë nga llogaritja e gabuar e Të Hyrave të Lejuara dhe e Kostos së Energjisë, raportimi i gabuar i Të Hyrave Rregullative të realizuara dhe Kostos së realizuar të Enregjisë apo apelimet lidhur me Përshtatjen e Rregullt do të mbulohen në Vitet Relevante vijuese.
- 7 Nëse Rregullatori nuk reagon ndaj Gjeneratorit të Rregulluar brenda kohës së kërkuar atëherë supozohet automatikisht se propozimi për të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Kostoja e Energjisë aprovohet dhe këto të Hyra bëhen efektive nga dita e parë e Vitit Relevant vijues.
- 8 Gjeneratori i Rregulluar mund të apelojë çdo vendim të Rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

SHTOJCA 6

PROCESI I SHQYRTIMEVE TË JASHTËZAKONSHME

- 1 Nëse ka ndodhur një Ngjarje e Jashtëzakonshme, Gjeneratori i Rregulluar mund të kërkojë Shqyrtim të Jashtëzakonshëm.
- 2 Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm nuk mund të fillojë brenda [gjashtë muajsh] të Shqyrtimit Periodik apo para kompletimit të një Shqyrtimi të Jashtëzakonshëm të kaluar.
- 3 Shqyrtimi i jashtëzakonshëm mund të ketë lidhje me më shumë se një Ngjarje të Jashtëzakonshme. Në këto raste kjo Shtojcë adreson ndikimin e përbashkët financiar të këtyre Ngjarjeve.
- 4 Brenda [20 Ditëve të Punës] pas kërkesës së Gjeneratorit të Rregulluar për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm, Gjeneratori i Rregulluar duhet të dorëzojë Deklaratën për Ndikimin Financiar që do të përfshijë çështjet në vijim:
 - 4.1 Përshkrimin e Ngjarjes së Jashtëzakonshme që ka qenë shkak i kërkesës për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm;
 - 4.2 Përshkrimin e ndikimit të Ngjarjes së Jashtëzakonshme në biznesin e Gjeneratorit të Rregulluar;
 - 4.3 Vlerësimin e ndryshimit të kostove të Gjeneratorit të Rregulluar në çdo vit nga data e Ngjarjes së Jashtëzakonshme deri në fundin e Periudhës së tanishme Rregullative;
 - 4.4 Vlerësimin për ndryshimin në të hyrat e parashikuara që rezultojnë nga Ngjarja e Jashtëzakonshme në çdo vit nga data e Ngjarjes së Jashtëzakonshme deri në përfundim të Periudhës së tanishme Rregullative;
 - 4.5 Llogaritjen për ndikimin financiar të Ngjarjes së Jashtëzakonshme në çdo vit, duke llogaritur si shuma e ndryshimeve në koston dhe të Hyrat e Gjeneratorit të Rregulluar. Të Hyrat do të trajtohen si numër pozitiv dhe koston do të trajtohen si numra negativ; dhe
 - 4.6 Llogaritjen nëse apo jo ndikimi financiar pritet të jetë më i lartë se Pragu i Materialitetit, shumëzuar me të Hyrat e Gjeneratorit të Rregulluar (në vitin para Ngjarjes së Jashtëzakonshme), shumëzuar me numrin e viteve në mes të datës së Ngjarjes së Jashtëzakonshme dhe fundit të Periudhës Rregullative. Pragu i Materialitetit duhet të jetë një përqindje fikse që caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike
- 5 Nëse Gjeneratori i Rregulluar vlerëson se ndikimi financiar është më i lartë se Pragu i Materialitetit, Gjeneratori i Rregulluar duhet të përfshijë në Deklaratën e Ndikimit Financiar propozimin për Përshtatjen e Jashtëzakonshme në Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe/ose Kostove të Energjisë. Propozimi për Përshtatjen e Jashtëzakonshme duhet t'u përmbahet kushteve në vijim:
 - 5.1 Përshtatja e jashtëzakonshme duhet të ndryshojë Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe/ose Kostot e Energjisë në atë mënyrë që Vlera Neto e Tanishme e ndryshimeve të parashikuara është e barabartë (por jo me shenjë të kundërt) me Vlerën Neto të Tanishme të ndikimit financiar të Ngjarjes së Jashtëzakonshme duke përdorur Mesatarën e Ponderuar të Kostos së Kapitalit si normë të diskontimit;

- 5.2 Koha dhe struktura e Përshtatjes së Jashtëzakonshme do të shmangë, ku është e mundur, rritjet e menjëhershme të tarifave të konsumatorët (për shembull duke zbutur ndikimin e Përshtatjes së Jashtëzakonshme brenda disa viteve).
- 6 Rregullatori mund të fillojë Shqyrtim të Jashtëzakonshëm pa kërkesën e Gjeneratorit të Rregulluar. Në këto raste, Rregullatori do ta njoftojë Gjeneratorin e Rregulluar dhe do të përfshijë një përshkrim të Ngjarjes së Jashtëzakonshme si dhe një përshkrim të ndikimit të parashikuar. Pastaj, Gjeneratori i Rregulluar do të përgatisë Deklaratën për Ndikimin Financiar sipas procesit të përshkruar më lartë.
- 7 Rregullatori mund të kërkojë sqarime shtesë për mënyrën e llogaritjes së Deklaratës për Ndikimin Financiar si dhe për Përshtatjen e Jashtëzakonshme dhe, në bazë të kësaj kërkesë, Gjeneratori i Rregulluar do t'i dërgojë Rregullatorit, brenda një afati sa më të shkurtër kohor, informatat e kërkuara.
- 8 Brenda [20 ditëve] pas marrjes së Deklaratës për Ndikimin Financiar, Rregullatori do të njoftojë Gjeneratorin e Rregulluar nëse Rregullatori e pranon apo jo propozimin e Gjeneratorit të Rregulluar për Përshtatjen e Jashtëzakonshme. Rregullatori do ta aprovojë propozimin nëse propozimi:
- 8.1 I plotëson kushtet e përshkruara më lartë;
- 8.2 Është llogaritur në mënyrë të saktë; dhe
- 8.3 Merr parasysh të gjitha informatat e nevojshme dhe të mundshme gjatë asaj kohe.
- 9 Nëse Rregullatori e aprovon propozimin për Përshtatjen e Jashtëzakonshme, propozimi për të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe/ose për Kostot e Energjisë do të jetë efektiv menjëherë.
- 10 Nëse Rregullatori nuk e aprovon propozimin për Përshtatjen e Jashtëzakonshme, Rregullatori duhet të ofrojë arsyetimin dhe evidencën për këtë, në pajtim me këtë Rregull. Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe/ose Kostot e Energjisë nuk do të përshtaten deri sa Rregullatori të aprovojë një propozim.
- 11 Nëse Rregullatori nuk e njofton Gjeneratorin e Rregulluar brenda afatit të kërkuar (lart), supozohet automatikisht se propozimi për Përshtatjen e Jashtëzakonshme është aprovuar dhe propozimi bëhet efektiv menjëherë.
- 12 Gjeneratori i Rregulluar mund të apelojë çdo vendim të Rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

- 1 Ngjarja e Jashtëzakonshme ndodhë në rastet e mëposhtme:
 - 1.1 Çdo ndryshim mbi 3% në taksat e aplikueshme në Kosovë dhe që nuk mbulohet tërësisht në Përshtatjet e Rregullta;
 - 1.2 Çdo forcë madhore që është definuar në Shtojcën 8;
 - 1.3 Çdo ngjarje tjetër që përmbushë të gjitha kushtet në vijim:
 - (i) Nuk është paraparë në mënyrë të arsyeshme;
 - (ii) Nuk ka qenë nën kontrollin e Gjeneratorit të Rregulluar;
 - (iii) Gjeneratori i Rregulluar nuk është i obliguar ta ndalojë atë;
 - (iv) Nuk do të mbulohet në Përshtatjet e Rregullta; dhe
 - (v) Ndryshon në masë të konsiderueshme të Hyrat dhe/ose kostot e Gjeneratorit të Rregulluar për ndonjë periudhë të caktuar 12 mujore, në atë mënyrë që mund të vlerësohet që mund të tejkalohet Pragu i Materialitetit (i sqaruar në Shtojcën 6)
- 2 Ndodhja e Ngjarjes së Jashtëzakonshme është e mjaftueshme për të filluar Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm por, siç është sqaruar në Shtojcën 6, Ngjarja duhet të kalojë Pragu e Materialitetit në mënyrë që të përshtaten Të Hyrat Maksimale të Lejuara.

SHTOJCA 8

NGJARJA E FORCËS MADHORE

- 1 Forca Madhore është ngjarje e jashtëzakonshme apo rrethanë që i përmbushë të gjitha kushtet në vijim:
 - 1.1 Është jashtë kontrollit të Gjeneratorit të Rregulluar;
 - 1.2 Gjeneratori i Rregulluar nuk ka mundur ta parandalojë atë;
 - 1.3 Gjeneratori i Rregulluar nuk ka mundur ta shmangë apo ta tejkalojë; dhe
 - 1.4 Nuk i atribuohet Gjeneratorit të Rregulluar.

- 2 Forca madhore mund të përfshijë, por nuk kufizohet me ngjarjet e veçanta apo rrethanat e paraqitura më poshtë atëherë kur kushtet e lartpërmendura janë përmbushur:
 - 2.1 Luftë, gjendje lufte apo veprime ushtarake (pavarësisht se a është deklaruar luftë apo jo), invazion, akt i armiqve të jashtëm;
 - 2.2 Rrebelim, terrorizëm, sabotim nga persona që nuk janë punonjës të Gjeneratorit të Rregulluar, kontraktorë apo nënkontraktorë, revolucion, kryengritje, uzurpim apo luftë civile;
 - 2.3 Trazirë, rrëmuje, grevë apo lokaut nga persona që nuk janë punonjës, kontraktorë apo nën-kontraktorë të palës;
 - 2.4 Municione të luftës, materiale eksplozive, rrezatim ionizues apo kontaminim me radio-aktivitet, përveç kur këto mund t'i atribuohen përdorimit të palës; dhe
 - 2.5 Katastrofat natyrore si tërmeti, tsunami, tajfuni apo aktivitetet vullkanore.

SHTOJCA 9

PROVIZIONET TRANZITORE

- 1 Periudha Tranzitore është nga data 1 prill 2012 deri më 31 mars 2016.
- 2 Periudha e parë Rregullative do të jetë [4 vite].
- 3 Rregullatori do të definojë vlerën hapëse të Bazës së Aseteve të Rregulluara (për datën 1 prill 2012) para fillimit të Periudhës së Parë Rregullative.